



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ORAHOVËCIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odheljenje za Opštu Upravu



-III- Nr. i prot 1286 Më 14.04 2022
Br. prot Dt.
ORAHOVEC - ORAHOVAC



Republika e Kosovës Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Odeljenje za Budžet i Finansije-Department of Budget and Finance

RAPORTI I PUNËS JANAR-MARS 2022

Përmbajtja

HYRJE	3
1. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA	3
2. BUXHETI 2022	4
3. PUNËT E REALIZUARA JANAR-MARS.....	4
4. JANAR-MARS BUXHET,ALOKIM,SHPENZIM	5
4.1 Paraqitja grafike	5
5. TË HYRAT VETANAKE	6
6. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË	6

HYRIJE

- Ky raport përfshinë të dhënat për periudhën Janar- Mars 2022 nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, konkretisht nga sektori për Buxhet dhe Financave dhe sektori i Tatimit në Pronë.

1. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Bazuar në obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë ne si drejtori kemi kryer të gjitha detyrat dhe obligimet që i takojnë kësaj drejtorie.
- Në Drejtorinë e Financave kemi arritur që detyrat të kryhen në afate ligjore, dhe çdo e hyre dhe shpenzim të evidentohet, në sistemin e SIMFK dhe data bazën e brendshme.
- Gjate kësaj periudhe të punës kemi mbajtur disa takime me Ministrinë e Financave, me AKK dhe organizata të ndryshme apo donator që kryesisht janë trajtuar çështjet financiare.
- Tek shpenzimet Operative kemi arritur të kursejmë disa shpenzime pa e dëmtuar procesin e punës, duke i rritur disa shpenzime-shërbime të cilat në të kaluarën janë paguar nga Kapitalet e realisht kanë qenë Mallra dhe Shërbime, siç janë, mirëmbajtja e ndërtesave , mirëmbajtja e rrugëve, sinjalizimet horizontale dhe vertikale ,rrënimet e ndërtimeve pa leje etj. duke respektuar edhe afate ligjore të cilat janë të rregulluara me ligjet për Financat Publike.

2. BUXHETI 2021

➤ Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2021 ndahet në dy fonde burimore:

- Grandi i qeveritar13,703,112.00 €
- Të hyrat vetanake1,350,548.00 €
- Gjithsej:.....15,053,660.00 €

➤ -Buxheti për vitin 2021 i shpërndarë sipas kategorive ekonomike:

- Paga dhe Mëditje7,897,674.14 €
- Mallra dhe Shërbime.....1,735,094.03 €
- Shpenzime Komunale27,000.00 €
- Subvencione dhe Trasnfere360,000.00 €
- Investime Kapitale.....4,790,891.83 €

3. PUNËT E REALIZUARA JANAR-MARS


➤ Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar këto detyra:

- Zotime, pranime, shpenzime për Mallra dhe Shërbime ,shërbime komunale ,subvencione dhe transfere , dhe investime kapitale dhe përgatitja e ndryshimeve në listën e pagave për punëtor.
- Përgatitja e raportit financiar në baza tremujor 2022 për Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e Komunës.
- Raportimi i obligimeve financiare në baza mujore në Ministrin e Financave.
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore(shpenzimet dhe të hyrat) për publikim në Web faqen e Komunës.
- Përgatitja e dokumentacionit për bartjen e mjeteve nga viti 2021 për Kuvend, dhe Ministrin e Financave.
- Përgatitja e shkresave, kërkesave të ndryshme gjatë kësaj periudhe si dhe raportime në mbledhjet e bordit të drejtorëve dhe Kryetarit të Komunës .

4. JANAR-MARS BUXHET,ALOKIM,SHPENZIM

Kategoritë Ekonomike	Buxheti sipas planifikimit	Alokimet SIMFK	Shpenzimet	Progresi ne % me planifikim	Progresi % me alokim
Pagat dhe mëditjet	7,897,674.14	1,966,232.45	1,889,486.76	23.92	96.10
Mallrat dhe Shërbimet	1,735,094.03	1,636,094.03	337,428.66	19.45	20.62
Shpenzimet komunale	270,000.00	270,000.00	64,115.78	23.75	23.75
Subvencionet dhe transferet	360,000.00	124,950.22	31,500.00	8.75	25.21
Shpenzimet kapitale	4,232,479.73	3,546,931.73	1,243,013.73	29.37	35.04
Rezerva	690,000.00	-			
GJITHSEJ	15,185,247.90	7,544,208.43	3,565,544.93	23.48	47.26

4.1 Paraqitja grafike



5. TË HYRAT VETANAKE

- Të hyrat e përgjithshme vetanake të planifikuara për vitin 2022 janë 1,350,548.00 euro, për këtë periudhë janë realizuar në shumë 255,331.56 apo 18.90 % të planifikimit vjetor.

6. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

- Gjatë periudhës Janar-Mars 2022 sektori i tatimit në pronë ka realizuar të hyra në shumë prej 98,243.77 euro apo 18.46 % të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 532,117.00). Regjistrimet e reja janë 90 objekte , ose 29,558 m2. Verifikimi i objekteve 717 , ose 112,010 m2.

-Vërejtje :Të gjitha të dhënat që janë të paraqitur janë përgatitur në bazë të raporteve deri me 31.03.2022

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

